



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 52 dt. 22.08.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 22.08.2014, pasi shqyrtoi çështjet e diskutuara më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesa punimesh në Sheshin Nënë Tereza.
2. Të hiqen nga fasadat e objekteve: Rektorati i Universitetit të Tiranës, Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Universiteti i Arteve, shkronjat që emërtojnë këto institucione.
Me qëllim unifikimin e tabelave emërtuese në objektet të Sheshit “Nënë Tereza”, të cilat janë monument kulture të kategorisë së II (dytë), institucionet e mësipërme dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës të paraqesin propozimin për këto tabela pranë Sekretarisë Teknike të Këshillit Kombëtar të Restaurimit.
3. Miratimin e disa shtesa punimesh në Muzeun Historik Kombëtar.
4. Miratimin e disa shtesa punimesh në Pallatin e Kongreseve.
5. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

